



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 612, Datë 19.04.2019

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit të miellit,

VËREN SE :

1. Me anë të vendimit nr. 551, datë 04.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit” është vendosur hapja e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit për periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 30.09.2018, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe/ose 9 të ligjit nr. 9121/2003, si dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në

nenin 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, gjatë periudhës së hetimit paraprak është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe në mënyrë të përsëritur nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Informacioni i administruar, deri në shtator të vitit 2018 nuk është i mjaftueshëm për konkludimin e procedurave hetimore.

3. Me qëllim vlerësimit dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, lind nevoja për hetime të mëtejshme, prova dhe të dhëna shtesë nga ndërmarrjet prodhuese dhe importuese si dhe e zgjatjes së periudhës hetimore për administrimin e të dhënave për periudhën shtator 2018-mars 2019 për importin e grurit dhe të miellit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak është i domosdoshëm për të siguruar një vendim marrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës 551, datë 04.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit" bëhen këto ndryshime:
 - a. Objekti i hetimit të ndryshohet si vijon: "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të grurit dhe të miellit";
 - b. afati në pikën "II" të shtyhet deri në 1 prill 2019 si dhe
 - c. afati i përcaktuar në pikën "III", shtyhet me 3 (tre) muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS